



URDHËRI PROFESIONAL I MJEKUT VETERINAR TË SHQIPËRISË

Nr. 202 Prot

Tiranë 08 / 05/ 2018

Lënda: Për vënien në dijeni të Vendimit të Komisionit të Disiplinës,

Drejtuar: Znj. Juliana MEMEJ

Kryetare e Bashkisë Ura-Vajguore,

BERAT

Për Dijeni: Z. Fatmir XHAFAJ

Ministër i Brendshëm

TIRANË

Për Dijeni: Z. Agim ISMAILI

Drejtor i Përgjithshëm i Autotitet Kombëtar të Ushqimit

TIRANË

Për dijeni: Znj. Luljeta ÇUKO

Drejtor i Drejtorisë së Derregullimit, Lejeve, Licensave dhe Monitorimit

TIRANË

E nderuar Znj. Kryetare,

Ju vëmë në dispozicion **Vendimin Nr 5, datë 02/05/2018 “Për Dhënje Mase Disiplinore”** për Z. Marjus Daja, mjek veteriner pranë Bashkisë Ura Vajguore; Berat, me motivacionin për shkelje të kërkesave të legjislacionit veterinar gjatë kryesjes së detyrës së tij funksionale.

Sa më sipër lutemi merrni në konsiderate zbatimin e Vendimit të Komisionit të Disiplinës të Urdhrit të Mjekut Veterinar të Shqipërisë.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin, ju urojmë punë të mbarë.

PRESIDENTI

Thoma PURIÇI



URDHRI I MJEKUT VETERINAR TË SHQIPËRISË

VENDIM

Nr 5, date 02/05/2018

“Për Dhënje Mase Disiplinore”

Me datë 02.05.2018, *Trupa e Gjykimit Profesional* e përbërë nga :

1. Zoti Adila KOJDHELI, Kryetar,
2. Zoti Fatmir OZUNI, Anëtar,
3. Zoti Ervin RESULI, Anëtar

Mori në shyrtrim informacionin e AKU, me shkresë nr 2798, date 17/04/2018 për disa shkelje të kërkesave të legjislacionit veterinar nga mjeku veterinar zoti Marjus Daja, si dhe pas verifikimit në terren, konkludoi sa më poshtë:

Zoti Marjus Daja gjatë kryerjes së detyrës së mjekut veterinar pranë Bashkisë Ura Vajguore, Betrat, ka leshuar çertifikata levizje kafshesh, në kundërshtim me legjislacionin veterinar,

Trupa e Gjykimit Profesional, pas verifikimit në terren dhe të shqyrtimit të dokumentacionit përkatës, konstatoi se zoti Marjus Daja, ka kryer shkelje të përsëritura, të cilat kanë krijuar premisa për hedhjen në treg të produkteve të pasigurta dhe me rrezik për jeten e konsumatorëve.

Bazuar në nenin 18, pika 1, germa b, dhe c, të ligjit 113/2015: Për Urdhrin Profesional të Mjekut Veterinar, *Trupa e Gjykimit Profesional* :

VENDOSI

1. Zotit Marjus Daja, t'i jepet vërejtje me paralajmërim për një periudhë 6 mujore,
2. Ti vendosë gjobë 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë
3. Ky vendim t'i bëhet i njohur me shkresë zyrtare, B. Ura-Vajguore brenda dt 12.05. 2018
4. Bazuar në pikën 11 të Rregullores të Komisionit të Disiplines ky vendim mund të ankimohet brenda 30 ditësh

